



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

**K.Dh.Sh II.nr.965/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbare të kreditorit “Deloitte Kosova”, Sh.p.k me NUI: ..., me seli në Prishtinë, rr.“Ukshin Hoti” nr.120, kundër debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.403/22 të datës 27.04.2023, me datë 13.11.2023, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Deloitte Kosova”, Sh.p.k, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.403/22 të datës 27.04.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.403/22 të datës 27.04.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbare P.nr.464/20 të dt. 13.08.2020, të Përmbaresit Privat V. B. dhe në tërësi është përfunduar përmbaremi në këtë çështje përmbare.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të refuzoj prapësimin e debitorit SHSKUK të ushtruar kundër urdhrin përbarimor P.nr.464/20, i datës 13.08.2020 apo lëndën ta kthej në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Deloitte Kosova", Sh.p.k, me datën 13.08.2020 ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë faturës nr. 464/K/2020 dhe faturës nr.465/K/2020 në shumën e përgjithshme prej 97,999.00€ me kamatë të kontraktuar nga data e arritjes për pagesë datë 17.07.2020 e deri në ditën e përmbushjes si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përbaruesi Privat V. B. me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr.464/20, dt.13.08.2020 e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke theksuar se shërbimi për fizibilitet në sektorin e Hemodializës dhe Sterilizimit të cilat janë kontraktuar nga SHSKUK me OE- "Deloitte Kosova" Sh.p.k., sipas raporteve të menagjerëve të kontratave i njëjti operator ekonomik nuk i ka përmbushur obligimet kontraktuese të parapara me kushtet e veçanta dhe në kushtet e përgjithshme.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori duke theksuar se prapësimi i debitorit është i palejuar dhe tërësisht pa bazë ligjore për arsye se i njëjti nuk përmbush asnjë nga kushtet që parashihen me nenin 71 të LPP-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.403/22 të datës 27.04.2023, ku në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr.464/20 të dt. 13.08.2020, të Përmbaruesit Privat V. B. dhe në tërësi është përfunduar përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret faturat në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbarimore nuk i përmbushin të gjitha kriteret për të lejuar përmbarimin pasi që faturat në bazë të cilave është mbështetur propozimi për përmbarim janë bashkangjitur në kopje ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Ndërsa me nenin 37 të LPP-së parashihet se “ *Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se faturat si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi janë bashkangjitur në kopje nuk janë të deponuara në origjinal apo kopje të vërtetuar tek organi kompetent ashtu siç parashihet me nenin 37 të LPP-së. Andaj, rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohen si dokument i besueshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga faturat mirëpo në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Sh II.nr.965/23, me datë 13.11.2023

**Gjyqtarja,**

**Ernaciska Zhitija-Ymeri**